



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTAR

Nr. 5086 / Prot

Tiranë më, 01.12.2022

Lënda : Kthim përgjigje kërkesës për informacion, datë 18.11.2022.

Drejtuar: Jona Plumbi

e-mail: jona@faktoje.al Nr. Tel: 0692680234

Baza Ligjore: Ligji nr.119, datë.18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”

E nderuar znj. Plumbi,

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare (DSHQ) është njohur dhe ka administruar me vëmendje të veçantë kërkesën tuaj për informacion nr.5086 Prot., datë 18.11.2022. Në cilësinë e institucionit që funksionon në bazë të kuadrit normativ përkatës (Vendim i Këshillit të Ministrave nr.34, datë 07.01.1999 “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta” (ndryshuar me VKM nr 678, datë 15.12.2000; nr.399, datë 22.8.2002; nr.411, datë 11.7.2007; nr.5, datë 14.1.2012; nr.463, datë 27.5.2015; nr.620, datë 01.11.2017; nr.768, datë 26.12.2018), DSHQ ka për detyrë mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rezidencave qeveritare në funksion të nevojave të autoriteteve të larta shtetërore që kanë tagër ligjor t’i aksesojnë dhe t’i përdorin si dhe të miqve të vendit të ftuar prej tyre.

Në këtë kontekst dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, rezidencat qeveritare dhe mjediset e tyre, qofshin të brendshme ose të jashtme, nuk janë mjedise publike apo të aksesueshme nga publiku.

Për sa i takon rezidencës qeveritare Vila 31, objekt i kërkesës suaj për informacion, sqarojmë se objekti është nën administrim të DSHQ sipas përcaktimeve të VKM nr.1058, datë 16 korrik 2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave pasuri të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave”. Në gjendjen e saj aktuale, kjo rezidencë nuk ka të ekspozuara për publikun vepra arti dhe statuja, si ajo së cilës i referoheni.

Statuja në fjalë, e kataloguar si pronë e Galerisë Kombëtare të Arteve (GKA), është zhvendosur në mjediset e brendshme të Vilës 30, për shkak të punimeve të rindërtimit të kësaj Galerie, sikundër edhe disa vepra të tjera arti që ishin në mjediset e saj. Kjo statuje ka qenë për një kohë të gjatë e vendosur në një hapësirë publike mbrapa Galerisë Kombëtare. Duke qenë e kataloguar si një vepër arti e fondit të Galerisë, në bazë të bashkëpunimit institucional midis Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në dhjetor 2021 u dakordësua ruajtja e saj në

cilësinë e objektit të artit, pjesë e koleksionit të GKA, nëpërmjet vendosjes në një mjedis jopublik, siç është mjedisi i Vilës 30.

Bashkëlidhur kësaj përgjigjeje dhe sipas kërkesës, ju dërgohet:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.34, datë 07.01.1999 “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare” (i ndryshuar).

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1058, datë 16.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave pasuri të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave” për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Duke ju falenderuar,

KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Josi Ballauri

